



Në mbështetje të nenit 12, pika 1 dhe pika 2, shkronja d), nenit 14, pika 1, nenit 17 shkronja c), nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57, dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.07.2024, miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik ndërtesat O-71510057-00644-0-16-0, në Zonën Kadastrale Rahovec

- Me këtë vendim, shpallen me interes të përgjithshëm publik ndërtesat (lokalet) e evidentuara si në vijim:
 - Ndërtesa (lokali), në sipërfaqe të përgjithshme prej 70.00 m² (shtatëdhjetë metra katror), në vendin e quajtur *M.POPOVIQA-M.POPOVIQ* e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim - *BASHKËPRONËSI NË NDËRTESEË NË PJESET E PËRBASHKËTA, të NSH "Borovo Vukovar"*.
 - Ndërtesa (lokali), në sipërfaqe të përgjithshme prej 74.64 m² (shtatëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e katër metra katror), në vendin e quajtur *M.POPOVIQA-M.POPOVIQ* e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim – *BASHKËPRONËSI NË NDËRTESEË NË PJESET E PËRBASHKËTA, të NSH "BANKKOS"*.
- Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të lokaleve të cekura në pikën 1, 1.1. dhe 1.2 të këtij vendimi, do të jetë: inicimi i procedurës për shpronësim.
- Autorizohet kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin kadastral, do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËSNËRAHOVEC

01Nr.236/24
Datë:25.07.2024

